

ISO 13823:2008, standard i ri i ISO-s për sigurinë, jetëgjatësinë e ndërtesave, strukturave inxhinierike dhe atyre industriale.

2008-08-05



ISO (Organizata Nderkombëtare e Standardizimit) ka publikuar një standard të ri për të ndihmuar inxhinierët, ndërtuesit dhe autoritetet shtetërore të projektojnë struktura të cilat janë të sigurta dhe rezistente nga dëmtimet për shkak të problemeve ambientale dhe mekanike dhe të degradimit të materialit.

Ndërtesat, punët inxhinierike civile, strukturat industriale etj. dhe komponentët e tyre duhet të jenë të menduara, të konstruara, të inspektuara, të mirëmbajtura dhe të riparuar në mënyrë të tillë që edhe në kushte mjedisore të paparashikueshme ato të ruajnë performancën e kërkuar gjatë projektimit me një besueshmëri të mjaftueshme për sigurinë dhe komoditetin e përdoruesve dhe për përdorimin e parashikuar të strukturës.

S SH ISO 13823:2008 – *Parimet e përgjithshme mbi konstruksionin e strukturave për qëndrueshmëri*, specifikon parimet e përgjithshme dhe rekomandon procedurat për verifikimin e qëndrueshmërisë të lëndës së strukturave për të njohur ose parashikuar veprimet ambientale, përfshirë këtu veprimet mekanike, që shkaktojnë degradimin e materialeve, të cilat çojnë në dështimin e performancës. Standardi ndihmon në sigurimin e besueshmërisë së performancës gjatë jetëgjatësisë të strukturës.

Ky standard Ndërkombëtar ka objektivat e mëposhtme:

- të përmirësoje vlerësimin dhe projektimin e strukturave për qëndrueshmërinë, duke inkorporuar parimet shkencore të ndërtimit në praktikën inxhinierike strukturale.
- të sigurojë kuadrin për zhvillimin e një modeli matematik për të parashikuar jetëgjatësinë e komponenteve të strukturës.

Prof. A.M. Brandt, Kryetar i Komitetit Teknik (TC) ISO/TC 98, *Bazat për projektimin e strukturave*, komenton: “Parimet e përgjithshme në verifikimin dhe projektimin e strukturës dhe komponentëve për qëndrueshmëri në këtë standard Ndërkombëtar do të përdoren kudo ku kërkohet një minimum i jetëgjatësisë së shërbimit për strukturat e reja si edhe për vlerësimin e strukturave ekzistuese.

Standardi ka për qëllim të luajë të njëjtin rol harmonizues si ISO 2394:1998, *Parimet e përgjithshme në sigurinë për strukturat*, gjatë 30 viteve të kaluara për verifikimin dhe projektimin e strukturave përkundrejt dëmtimeve si pasojë e problemeve mekanike, duke variuar nga graviteti tek era, bora dhe tërmeti.

Qëllimi është të garantojë, se të gjitha modelet analitike janë të ndërthurura në metodën e gjëndjeve të limituara, e njëjtë me atë që momentalisht përdoret për verifikimin dhe projektimin e strukturave.

S SH ISO 13823:2008 mbulon:

- konceptin bazë për të verifikuar qëndrueshmërinë
- kërkesat e qëndrueshmërisë
- projektimi i jetëgjatësisë dhe komponentët e saj
- parashikimi i jetëgjatësisë së shërbimit
- strategjite për konstruksione të qëndrueshme.

Ky standard Ndërkombëtar nuk adreson direkt qëndrueshmëri për strukturat. Shumica nga pikat përbërëse të qëndrueshmërisë si përshembull zgjedhja e materialit që ndikon në konsumimin e energjisë dhe humbjet, janë jashtë fushës së tij, por në menyrë indirekte strukturat e qëndrueshme përmirësojnë qëndrueshmërinë e infrastrukturës.

ISO 13823 — *Parimet e përgjithshme në projektimin e strukturave për qëndrueshmëri*, u hartua nga Komiteti Teknik ISO/TS 98, *Bazat për projektimin e strukturave*, Nënkomiteti SC 2, *Siguria e strukturave*.

ISO 13823 — **Parimet e përgjithshme në projektimin e strukturave për qëndrueshmëri** është adoptuar si Standard Shqiptar (S SH), duke qënë identik me origjinalin, nga Komiteti Teknik i DPS, kushton **4938** lekë për jobashkëpunëtorë dhe **2469** lekë për bashkëpunëtorë dhe mund ta gjeni në zyrat e DPS-së në adresën:

Rruga: "Mine Peza", Nr. 143/3,

1014 -Tiranë, Shqipëri.

Kutia Postare 98

Tel: + 355 (04) 222 62 55

Fax: + 355 (04) 224 71 77

E-mail: info@dps.gov.al

Web: www.dps.gov.al